Kronikë

Trafik armësh nga Shqipëria në Greqi, videomesazhet që tradhëtuan 2 të arrestuarit! Mendohet se do çoheshin në Selanik

Detaje të reja nga tentativa për trafikim të armëve të zjarrit nga Kapshtica drejt Greqisë për të cilën më 6 tetor u arrestuan Xhimi Hoxha e Miklovan Veliu.

■ VIDEO/ Shikoni ku ishin fshehur armët

Armand Braho
7 Tetor, 13:48 | **Përditesimi: 7 Tetor, 14:05**

Share

KORCE - Detaje të reja nga tentativa për **trafikim të armëve të zjarrit nga Kapshtica drejt Greqisë** për të cilën më 6 tetor 2023 u arrestuan Xhimi Hoxha e Miklovan Veliu.

Sipas burimeve të konfirmuara në rrugë zyrtare bëhet e ditur se në Kapshticë automjeti u përzgjodh për kontroll në vijën e dytë pas analizës së riskut.

LEXO EDHE:
Muzika shkodrane 'zbret' në Pazarin e Vjetër të Korçës

Kontrollorët i bënë pyetje shoferit i cili shfaqi pasiguri më pas automjeti u kalua në vijë të dytë për kontroll të detajuar.

Armët u gjetën të fshehura poshtë sediljes së shoferit.

Po sipas të njëjtave burime destiancioni i armëve ishte Selaniku.

Ndërkohë sa i përket hetimit bëhet e ditur se dy të arrestuarit gjatë marrjes në pyetje nga specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme të DVP Korçë mohuan se kishin lidhje me njëri-tjetrin për trafikimin e armëve por pretendimet e tyre janë të pavërteta pasi policia gjeti dhe sekuestroi prova që faktojnë bashkëpunimin mes dy të arrestuarve. Bëhet fjalë për mesazhe dhe video që ata kanë shkëmbyer me njëri-tjetrin ku tregojnë si të sajojnë vendin në automjet për të fshehur armët.

Videot e mesazhet u gjetën në telefonin e njërit prej dy të arrestuarëve.

Videot e mesazhet janë administruar si prova materiale.

Mendohet se armët i kishte siguruar 41-vjeçari nga Tepelena, Xhimi Hoxha por me banim në Tiranë.

Lajmi ne perditesim...

S.G/Shqiptarja.com

TAG: trafik armesh | miklovan veliu | xhimi hoxha | Korce

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Vdekja e 3-vjeçarit, a duhen bërë kontrolle të rrepta në klinikat private?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

U rrëzua nga pema duke vjelur arrat, ndërron jetë 64-vjeçari në Korçë
7 Tetor, 16:12

Tentuan të trafikonin armë e municione nga Shqipëria në Greqi, arrestohen 2 persona në Kapshticë
6 Tetor, 19:15



Basha në Pogradec: Vendit sot i mungon një alternativë e përgjegjshme që shkon përtej fasadave
6 Tetor, 18:08

Përkujtohet Thoma Turtulli, filantropi i njohur korçar! I dhuroi Korçës bibliotekën, kinemanë, liceun e spitalin

Armand Braho
6 Tetor, 16:00

Burimas, uji i ndotur në çezma edhe pas investimit! Ujësjellësi: Po punon Bashkia Maliq, s'kemi përgjegjësi

Armand Braho
6 Tetor, 15:50

Aksident në Korçë, shoferi humb kontrollin e mjetit dhe del nga rruga! Plagosen 2 persona
5 Tetor, 21:40

Moti i keq dëmton të mbjellat në Kukës e Korçë, fermerët në Report Tv: Shteti të na ndihmojë! Zv.ministri: Duhet të ndryshojmë politikat, synimi ynë, të jemi pranë jush
5 Tetor, 20:52

Dhunoi njerkun e tij, arrestohet 35-vjeçari në Korçë! Në pranga edhe një shofer i ri, drejtonte mjetin pa patentë dhe në gjendje të dehur
5 Tetor, 10:30

Vendimet e qeverisë: FSHZH do kryejë procedurat e prokurimit për projektin e stadiumit "Skënderbeu" në Korçë
4 Tetor, 21:21

Përshtati lokalin për organizimin e lojërave të fatit, arrestohet 45-vjeçari! Një tjetër në pranga për vjedhje në Korçë
4 Tetor, 12:47

'Tetori rozë', e gjen pa mamografi spitalin e Korçës! Shefja e kujdesit parësor: Aparatura ka pësuar defekt! Ministria ofron 'zgjidhjen' alternative

Armand Braho
4 Tetor, 11:26

Skënderbeu 'bingo' me talentin 19-vjeçar, kur Ermir Rashica provohej te Interi në Serie A (VIDEO)
3 Tetor, 21:48

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje